

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot, falë denoncimeve të vazhdueshme të Partisë Demokratike, të tjerë zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste, ndër to edhe një deputet, po përballen me drejtësinë. Pa asnjë dyshim kjo skemë grabitjeje e parave të shqiptarëve nuk mund të bëhet pa dijeninë e ministrave dhe të Kryeministrit. Zbardhja e aferës së vjedhjes së 430 milionë euro nga xhepat e shqiptarëve dhe çuarja e të gjithë përgjegjësve përpara drejtësisë mbetet një sfidë jo e vogël e SPAK-ut në të ardhmen. Për t'u kthyer tek akti normativ, ne po diskutojmë për disa ndryshime në ligjin "Për buxhetin e vitit 2022", ku propozohet një shtesë fondesh në përballimin e krizës së çmimeve dhe të energjisë. Partia Demokratike mbështet çdo nismë reale, që synon t'u vijë në ndihmë qytetarëve. Por, a është e mjaftueshme për të lehtësuar xhepat e shqiptarëve në nevojë?

Flasim për 6 miliardë lekë, që do t'i shtohen buxhetit dhe do të shkojnë për paketën e rezistencës sociale, konkretisht për shtresat në nevojë, për transportin publik dhe për subvencione të fermerëve. Në Shqipëri, sipas INSTAT-i, jetojnë rreth 621 mijë e 500 persona nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër. Shqipëria ka treguesin më të lartë të rrezikut për të qenë të varfër në rajon. Pyetja ime është: sa prej këtyre qytetarëve do të mbështeten financiarisht nga paketa e rezistencës sociale? Sa prej tyre do të përfitojnë direkt nga fondi prej 6 miliardë lekësh? Në fakt, vetëm pensionistët e vetmuar dhe ata me pension të reduktuar, si dhe invalidët do të përfitojnë shumë qesharake prej 3 mijë lekësh në muaj. Pra, jo të gjithë pensionistët do të përfshihen në kategorinë përfituese. Po familjarët në pamundësi si do të lihen? Ata do të lihen, si përherë, të vetëm në përballimin e kësaj situatë të vështirë. Flasim për krizë, ndërkohë nuk po ndërmerret asnjë masë konkrete, përveçse propagandë.

Çmimet e shportës janë në nivelet më të larta. Taksa e naftës ka mbi 50% të vlerës totale të saj, duke qenë më e shtrenjta në rajon. Fermerët vazhdojnë ta blejnë karburantin me çmimin maksimal të tregut. Vaji, mielli, orizi, makaronat vazhdojnë me çmimet të larta dhe me trend ngjitës. Dukshëm ditët e fundit është rritur edhe prezenca e deputetëve të maxhorancës nëpër tregje e markete, duke bërë njëkohësisht inspektorin dhe propagandën. Partia Demokratike ka propozuar, ndër të tjera, heqjen e TVSH-së nga produktet e shportës dhe reduktimin e taksave të karburantit, pika të cilat nuk janë përfillur nga qeveria dhe nga maxhoranca. Ndërkohë, vendet fqinje kanë miratuar paketa reale ndihme, me vlera mbi 10- fish më të mëdha, në raport me popullsinë target, duke marrë parasysh këtu edhe pagat, të cilat janë më të larta në raport me Shqipërinë, duhet të themi që kjo që jepet me paketën e rezistencës sociale nuk është gjë tjetër veçse thërrime të lëshuara ndaj qytetarëve në nevojë të këtij vendi dhe këto të dhëna në mënyrë selektive.

Transporti publik, ai ndërqytetës, tashmë e ka dyfishuar koston e biletës. Bujqësia është në falimentim. Ka zero subvencione për shumicën e fermerëve. Greqia, një nga vendet fqinje, jep 180 litra karburant vetëm për 3 muajt e krizës, ne jemi duke dhënë në mënyrë të vazhdueshme naftë elektorale vetëm përpara fushatave elektorale. Plehrat kimike me çmimet stratosferike, pa asnjë kontroll e kosto shpeshherë abuzive. Së fundi, do të doja të konkludoja duke thënë se masat e ndërmarra për përballimin e krizës janë të pamjaftueshme duke filluar nga taksat, që rëndojnë koston e produkteve, të cilat ju refuzoni t'i reduktoni dhe deri në mungesën e përkrahjes së duhur dhe reale ndaj qytetarëve. Faleminderit!